



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVO  
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E  
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË  
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA  
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY  
DVSM

# *TESTI I MATURËS*

**ARSIMI PROFESIONAL III**  
(ADMINISTRATË, EKONOMI, ADMINISTRIM BIZNESI,  
HOTELERI, TURIZËM)



Prishtinë, qershor 2009

Emri dhe mbiemri i nxënësit .....


Shkolla.....

### Udhëzime:

**Koha:** Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

### Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

### Lexo paragrafin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Zoti nderçur' e vëlla i dashurë!

Punërat që po bën Lidhje e Shqipërisë në Gegëri, që nonjë muaj e tëhu, mbase nuk i kini dëgjuarë, se fletët e Evropësë nuk bëjnë shumë fjalë, duke me qenë mënjanë Turqia nuk lë të dëgjohenë nëpër botët, edhe mënjanë armiqtë tanë Greqt' e Shqehhtë, duanë t'i tregojnë të vogla e të mosgjëjta. Lidhja e Shqipëtarëvet që ka kërthizën në Pizdren, në Gegëri, ka kërkuar shumë herë, që nga tre vjet e tëhu, bashkimm' e Shqipërisë me një provincë me otonomi; po mbretëria gjer më sot e kish gënjyerë me fjalë, edhe s'ka dashurë të bënjë gjë fare për Shqipërinë.

Sami Frashëri

**1.** Fragmenti i dhënë është pjesë e një:

- A. raporti
- B. artikulli
- C. memorandum
- D. letërkëmbimi

**2.** Ideja themelore e këtij fragmenti përmbledhet në fjalinë:

- A. Turqia, Greqia e Serbia e pengonin jehonën e Lidhjes së Prizrenit
- B. Turqia, Greqia e Serbia e ndalonin mbajtjen e Lidhjes së Prizrenit
- C. Evropa e përkrahte organizimin e Lidhjes së Prizrenit
- D. Turqia përpiqej ta vinte nën kontroll Lidhjen e Prizrenit

### Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Konkurs për Petro Markon

Tiranë, 27 nëntor

Një skulpturë kushtuar shkrimtarit të njohur shqiptar, Petro Marko, do të vendoset në fshatin e tij të lindjes, në Dhërmi, në mars të këtij viti. Galeria Kombëtare e Arteve, dje në Tiranë ka shpallur konkursin, dhe fton artistët shqiptarë të marrin pjesë.

Në njoftimin e GKA-së thuhet se boceti mund të krijohet nga një artist i vetëm apo nga një grup artistësh. Ai nuk guxon të jetë pjesëmarrës apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme. "Boceti duhet të jetë shprehje artistike figurative me destinacion përjetësimin e figurës dhe personalitetit psikologjik të Petro Markos", thuhet në njoftim.

Afati për dorëzimin e këtij boceti pranë Galerisë së Arteve është 9 shkurti i vitit 2009.

Më datën 14 shkurt 2009, në orën 10.00 do të shpallet fituesi i çmimeve nga Juria e konkursit, në mjediset e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

"Juria e konkursit do të jetë e përbërë nga 5 anëtarë, personalitete nga fusha e artit dhe kulturës, caktuar nga MTKRS", thuhet në njoftim.

*(Marrë dhe përshtatur nga gazeta „KOHA ditore”)*

**3.** Gjej se cila nga fjalitë në vijim është citat?

- A. Një skulpturë kushtuar shkrimtarit të njohur shqiptar, Petro Marko, do të vendoset në fshatin e tij të lindjes, në Dhërmi.
- B. Në njoftimin e GKA-së thuhet se boceti mund të krijohet nga një artist i vetëm apo nga një grup artistësh.
- C. Boceti duhet të jetë shprehje artistike figurative me destinacion përjetësimin e figurës dhe personalitetit psikologjik të Petro Markos.
- D. Më datën 14 shkurt 2009, në orën 10.00 do të shpallet fituesi i çmimeve nga Juria e konkursit, në mjediset e GKA-së në Tiranë.

**4.** Nëse në fjalinë: „Një skulpturë kushtuar shkrimtarit të njohur shqiptar, Petro Marko, do të vendoset në fshatin e tij të lindjes, në Dhërmi, në mars të këtij viti.”, jepet rendi i informatave sipas radhës **kush?; ku?; kur?; çka?**, atëherë në cilën nga alternativat renditja është e duhur?

- A. një skulpturë... / në fshatin e tij të lindjes / në mars të këtij viti / do të vendoset
- B. shkrimtarit të njohur shqiptar / në mars të këtij viti / në Dhërmi / Petro Marko...
- C. fshatin e tij / në mars të këtij viti / Petro Marko / një skulpturë...
- D. do të vendoset / në mars të këtij viti / në Dhërmi / një skulpturë...

**Lexoje me kujdes deri në fund këtë fragment të transliteruar dhe përgjigju pyetjes vijuese**

Zogu i Egrë, ma të shumenë herë është mai bukurë, se aj qi ritetë nder duertë Nierëzet, e nder pluhunitë shtëpisë e hitë votresë. Kështu ende Pemetë, qi përkitenë nukë piqenë mirë: po ma te shumenë herë kalbenë. Drini, e Buena kur dalenë jashtë brigjeshit se tyne, e rjedhnë ndëper bërraketë Hassit e Zadrimesë, ndo Sitnica e si Vardari ndëper Shkupt', e nde per Kossovet, gjithëherë ecinë e janë ma të turbulla; tue bajtunë me vetehe plehë e baltë; se kur ecinë Amesë vet: kështu femëna e silla ndjek shetitë, tue dalë shpesh me shkuem mot, shumë herë turbullon të dëliretë vet.

(Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, 1685)

**5.** Motivi kryesor i këtij fragmenti mbështetet në:

- A. mahnitjen nga bukuria e zogut të egër
- B. brengën për shpëtimin e moralit të femrës
- C. mbrojtjen e pemëve që nuk piqen mirë e kalben
- D. evitimin e vërshimeve të Sitnicës e Vardarit

**Lexo paragrafin dhe përgjigju pyetjeve vijuese**

Tagri, perlimi e detyra e të zot't të shpis.

Mbas Kanunit, sundimi i shpis i perket ma të vjetrit nen kulm të shpis a se vllaut të parë; po s'paten ato veti, qi duhen per me krye ket zyre si e lyp detyra, atbotë zgjidhet kuvendisht prej shpjakve njaj, qi të jet ma i meqem, i urtë e ma kujdestar.

Zot shpije mundet m'u ba edhe njeri i pamartuem.

(*Kanuni i Lekë Dukagjinit*)

**6.** Sipas këtij neni, personi i pamartuar:

- A. preferohet të jetë Zot shtëpie
- B. rekomandohet të jetë Zot shtëpie
- C. sugjerohet të bëhet Zot shtëpie
- D. lejohet të bëhet Zot Shtëpie

**7.** Fjalja: „Mbas Kanunit, sundimi i shpis i perket ma të vjetrit” në shqipen standarde bën:

- A. Simbas Kanunit, sundimi i shtëpisë i përket ma të vjetrit.
- B. Sipas Kanunit, sundimi i shtëpis i perket më të vjetërit.
- C. Sipas Kanunit, sundimi i shtëpisë i përket më të vjetrit.
- D. Simbas Kanunit, sundimi i shtëpis i perket ma të vjetrit.

**8.** Nëse fjalitë: „Muri nuk lartohej se nuk lartohej dot” dhe „Kërkohej një flijim në themele”, i bashkojmë në një periudhë të nënrenditur me marrëdhënie shkakore, periudha bën:

- A. Muri nuk lartohej se nuk lartohej ndonëse kërkohej një flijim në themele
- B. Muri nuk lartohej se nuk lartohej dot megjithëse kërkohej një flijim në themele
- C. Muri nuk lartohej se nuk lartohej dot edhe pse kërkohej një flijim në themele
- D. Muri nuk lartohej se nuk lartohej dot meqenëse kërkohej një flijim në themele

### Lexo paragrafin dhe përgjigju pyetjes vijuese

Tozeri tregon për vështirësitë që kishte hasur njëherë gjatë një vizite në një kullë; ai me gjithë shoqëruesit e tij:

... e rrethuan kullën dhe zunë të trokitnin në portë me një gur të madh ngaqë dera qe mbyllur dhe ne i dëgjonim hapat e të zotit të shtëpisë nga kati i epërm. Në e parë, u bë kinse s'na dëgjonte, dhe - kur më në fund zbriti, filloi të fliste diçka më vete para se të na pranonte, sepse - si i tha përkthyesit tonë, ai nuk e kishte të qartë pse ne duhej të vizitonim vendin pos nëse e kemi vendosur të ktheheshim rishmi për ta pushtuar më vonë.

(Faik Konica, *Shqipëria kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore, Prishtinë, 1990*)

9. Sipas fragmentit të mësipërm, një tipar i karakterit të të zotit të shtëpisë, që vëzhguesit (Tozerit) i ka rënë në sy, është:

- A. prirja e dyshimit ndaj të huajve
- B. frika nga mysafirët e paftuar
- C. mikpritja për mysafirin e shtëpisë
- D. ndjenja e respektit ndaj të huajve

### Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Zymtë e shikoi Akil këmbëshpejti e i foli:

- I. "o dhelpërak, me paturpësi i mbuluar,  
po kush nga akejt është gati që t'u bindet  
urdhërave të tu, e luan për ty nga vendi,  
o rrëmben armët të luftojnë me burra?  
Këtu s'kam ardhur të luftoj pse urreva  
trimat trojanë, pse faj ata s'më kishin,  
as kuaj, asgjë ata kurrë s'na grabitën,
- II. Por t'erdhëm pas, o faqezi pa cipë  
për t'mirën tënde, që në vend të çonim  
nderin e Atridit Menela ndër teukër,  
gjithnjë për ty, o turiqen, por t'gjitha  
këto ti i shkel dhe i përbuz me urrejtje,  
dhe më kanosesh të më heqësh dore  
frytin e djersës derdhur ndër beteja,  
t'vetmin shërbim që më dhuruan akejt.

(Homeri, *Iliada*)

10. Mllef i Akilit shprehet në vargun:

- A. këto ti i shkel dhe i përbuz me urrejtje
- B. Këtu s'kam ardhur të luftoj pse urreva
- C. o dhelpërak, me paturpësi i mbuluar
- D. as kuaj, asgjë ata kurrë s'na grabitën

11. Akili, në vargjet e lartpërmendura, i drejtohet:

- A. një orakulli
- B. prijësit të tij
- C. ushtarit të tij
- D. një trojani

### Lexo vargjet dhe përgjigju pyetjes vijuese

N'at Berlin na janë bashkue,  
Na kan nis me bisedue  
Se si pûnen me e vendue,  
Per me vû paq edhe besë,  
Zemër t'keqe, mní e resë,  
Tue ngulë gúr, tue ngulë kufi,  
Per gjith vend, per gjith mbretní  
Giatë Balkanit m'Dét të Zí

**12.** Diskursi poetik i këtyre vargjeve është:

- A. historik
- B. mitologjik
- C. elegjiak
- D. përkushtues

### Lexoje këtë poezi me kujdes, pastaj përgjigju pyetjes vijuese

#### Bjen sharkija e Ymerit

*Mjeshtrit të sharkisë – Ymer Rizës prej Gjakove*

Bjen sharkija e Ymerit,  
dridhen telat – shpirt' i gjallë.  
Rreth e rrotull rrin rinija,  
kur fillon me ra sharkija –  
zemrat flakë ajo i kallë.

Bjen sharkija e Ymerit,  
gishtat k'cejnë, mbi tel lodrojnë.  
Plaku kangën kur ia nisë  
nën mekamin e sharkisë –  
trupin dridhmat e përshkojnë.

Bjen sharkija e Ymerit,  
flet mbi t'shkuemen plot me gjak:  
mbi tiranë që shkretnu'n dhenë,  
e mbi burra që mbrojnë atdhenë –  
kur këndon Ymeri plak...

Bjen sharkija e Ymerit,  
dridhen telat – shpirt' i gjallë.  
Rreth e rrotull rrin rinija,  
zanat ndizen, s'menë sharkija –  
zemrat rriten bahen mal!

(Esad Mekuli, *Brigjet, Prishtinë, 1981*)

**13.** Forma poetike e kësaj poezie karakterizohet si:

- A. baladë
- B. ode
- C. sonet
- D. epigram

### Lexo paragrafët dhe përgjigju pyetjeve vijuese

- I. Në qytetin tonë asht një lagje... E në atë lagje asht një kishë. Mbrenda në kishë asht një lyps, në të cilin jeton një dëshirë: me jetue.
- II. Lypsi ka ardhë. Dhe me të vërtetë ka gjetë prehje. Lagshtina e kishës e fashiti të nxehtit e trupit të tij që gati e përvëloj. Jasht asht zheg. Dielli asht aq marrisht i nxehtë dhe aq egër të lëmon, sa që të rrahin tëmthas, si të rrahurat e farkëtarit mbi hekurin e skuqun.

(Migjeni, *Në kishë*)

**14.** Gradacioni zbritës në paragrafin e parë ndërtohet mbi këtë rend fjalësh:

- A. Qytet, Lagje, Kishë, Lyps, Dëshirë
- B. Lagje, Qytet, Brenda, Lyps, Me jetue
- C. Dëshirë, Lyps, Kishë, Lagje, Qytet
- D. Jetë, Lyps, Dëshirë, Kishë, Lagje

**15.** Cila nga fjalitë e mëposhtme ka gjuhë të figurshme?

- A. Në qytetin tonë asht një lagje
- B. Në kishë asht një lyps
- C. Dielli egër të lëmon
- D. Jasht asht shumë zheg

### Lexo fragmentin dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Ishe njëherë një gjeneral dhe një prift që kishin dalë për *kësmet*. Jo, nuk kishin dalë për *kësmet*. Ata kishin dalë për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të tyre të vrarë në një luftë të madhe. Ec e ec, kapërcyen shumë male e shumë fusha, duke kërkuar e duke mbledhur këto eshtra. Vendi ishte i ashpër e i keq. Frynin erëra e binin shira pa pushim. Por ata nuk u kthyen nga udha dhe ikën më tutje. Mblodhën sa mblodhën dhe u kthyen të numëronin ato që kishin mbledhur. Doli se mungonin ende shumë eshtra. Atëherë mbathën opingat e veshën zhgunat dhe u nisën prapë për udhë. Ec e ec, kapërcyen shumë male e shumë pllaja. Moti ishte i egër e i keq. U lodhën e u këputën e u plasi shpirtin kjo punë. As era, as dëbora nuk u tregonin ku gjendeshin ushtarët që kërkonin. Mblodhën sa mblodhën dhe u kthyen prapë të njehsonin ato që kishin mbledhur. I njehsuan dhe doli që kishin mbetur pa u gjetur ende shumë ushtarë. Atëherë, të lodhur e të rraskapitur, u nisën prapë për udhë të madhe. Ec e ec e udha s'kishte të sosur. Ishe dimër, binte borë.

**16.** Ky fragment dallohet që **nuk** është përrallë, për shkak të:

- A. përshkrimin
- B. rrëfimit
- C. personazheve
- D. hapësirës

**17.** Nëse në fjalinë: „Ata kishin dalë për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrarë”, përdoret **kryefjala në numrin njëjës** dhe **kallëzuesi i shprehur me folje në kohën e kryer të thjeshtë**, fjalia bën:

- A. Ai dilte për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrarë
- B. Ata dilnin për të mbledhur eshtrat e ushtarit të vrarë
- C. Ata dolën për të mbledhur eshtrat e ushtarit të vrarë
- D. Ai doli për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të vrarë

### Lexo fragmentin dhe përgjigju pyetjes vijuese

Po ta vija veten në rolin e tregimtarit pretencioz, këtë rrëfim do ta nisja me përshkrimin e rrugës përplot kthesa, që shpie drejt fshatit. Pra do të duhej të bëja një retrospektivë nga ato të mërzitshmet, duke përshkruar ndodhi të ndryshme të rastisura aty-këtu në thellësitë e kohës së kaluar dhe në hapësirat e ndryshme, gjithnjë me bindjen se ajo do të zgjojë interes, duke gënjyer vetveten e të tjerët me zbulurime.

(Kim Mehmeti, *Lulehëna, Pejë, 1997*)

- 18.** Në këtë fragment hetohet prania e dukshme e atij që rrëfen. Prania e kujt po hetohet?
- A. e autorit
  - B. e narratorit
  - C. e dikujt tjetër
  - D. e personazhit

### Lexo fragmentin dhe përgjigju pyetjeve vijuese

Idili mes Vitës, vashës së Shpiragajve, dhe Adilit, djalit të Tafilajve, është dimensionimi më fisnik i këtij romani; është vija tematike që i jep kuptim të fuqishëm tërë botës së këtij romani, botë së luftës për mbijetesë.

- 19.** Mbështetur në fragmentin e mësipërm, cili nga përfundimet është i saktë?
- A. Ky fragment është i formës eseistike dhe lidhet me romanin „Komisari Memo” të Dritëro Agollit
  - B. Ky fragment është i formës së kritikës letrare dhe lidhet me romanin „Romani për Kosovën” të Zejnullah Rrahmanit
  - C. Ky fragment është i formës eseistike dhe lidhet me romanin „Stina e stinëve” të Kasëm Trebeshinës
  - D. Ky fragment është i formës së kritikës letrare dhe lidhet me romanin „Lumi i Vdekur” të Jakov Xoxës
- 20.** Përfaqësues të Romantizmit në letërsinë shqipe janë:
- A. Sami Frashëri, Fan Noli, Zef Skiroi
  - B. Naim Frashëri, Zef Skiroi, Zef Serembe
  - C. Jeronim de Rada, Ndre Mjeda, Anton Zako Çajupi
  - D. Konstandin Kristoforidhi, Gjergj Fishta, Ernest Koliqi

## ENGLISH LANGUAGE

**21.** Choose the correct alternative to complete the following sentence:  
**Our generation reunion party was held on 28/4/2007. It was held on \_\_\_\_\_.**

- A. April twenty-eighth, of two thousand and seven
- B. twenty-eighth of April, two thousand and seven
- C. twenty-eight of the April, two thousand and seven
- D. the twenty-eighth of April, two thousand and seven

**22. Read the following sentences carefully:**

1. Hello, Jenny. This is Marcus, remember me from school?
2. I'm awfully sorry. I'm travelling tonight and...
3. Fine, thanks. Listen I wanted to invite you to a party tomorrow night...
4. Hello, 793 728 356.
5. Which school? Oh, hi Marcus. How are you?

**The correct order of sentences to form a dialogue is \_\_\_\_\_.**

- A. 1 2 5 4 3
- B. 2 1 4 5 3
- C. 4 1 5 3 2
- D. 4 3 5 2 1



**23.** Pierre, Johanna, Patrick, and Rebecca are e-mail friends. They communicate daily because they have many things in common. Look at the table below and choose the correct answer:

|                           | Pierre                       | Johanna                              | Patrick                             | Rebecca                             |
|---------------------------|------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------|
| Age?                      | 22                           | 18                                   | 23                                  | 16                                  |
| Job?                      | No                           | Yes                                  | Yes                                 | No                                  |
| Likes?                    | music, reading, cooking      | reading, computers, going out        | going to movies, music, writing     | writing, cooking, eating            |
| Plays (sports/instrument) | the guitar, the drums        | ice hockey, ice-skating              | the piano, baseball                 | tennis, basketball                  |
| Languages?                | English, French              | Swedish, English                     | English, Chinese                    | Spanish, English                    |
| Other information         | Hates dogs, works long hours | Interested in all sports, loves dogs | Loves cats and dogs and all animals | Hates ducks and cats but loves ants |

- A. Patrick likes going to movies, the others don't.
- B. Johanna likes cooking but Rebecca doesn't.
- C. Both Pierre and Johanna are employed.
- D. They all like reading and writing books.

**24.** ONLY ONE of the words below CANNOT be used to complete the following sentence. Which one?

Mat and his friends are in the final year of the high school. All the students in Mat's class are very successful. They have never failed at school because they are all very \_\_\_\_\_.

- A. hardworking
- B. idle
- C. diligent
- D. energetic

**25.** Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

**Bleron:** I didn't expect to find you home. What are you going to do tonight?

**Arta:** I don't know yet. \_\_\_\_\_.

**Bleron:** To tea?

- A. One of my neighbours has invited me...
- B. One of my neighbours has pleased me...
- C. One of my neighbours has welcomed me...
- D. One of my neighbours has suggested me...

**26.** The sentence 'We have never been so happy in our lives.' is in the \_\_\_\_\_.

- A. Present simple tense
- B. Present continuous tense
- C. Present perfect tense
- D. Present perfect continuous tense

**27.** In the following dialogue:

**Bertha:** I went to visit a friend of mine who lives in Leeds.

**Maggie:** Oh, really? Where is Leeds \_\_\_\_\_?

from the following words:

1. situated
2. built
3. found
4. repositioned

Maggie should say, '**situated**' because \_\_\_\_\_.

- A. this is the place where they are building the city.
- B. this is the place where the city is located geographically.
- C. this is the exact place where you find the situation and place.
- D. this is where they have found the city and placed it again.

**28.** Choose the correct answer to complete the sentence:

**Didn't you know that \_\_\_\_\_ cannot be bought in the library?**

- A. books
- B. the books
- C. those books
- D. some books

**29.** Look at the following nouns. One of them does not exist. Which one?

- A. punishment
- B. parliament
- C. agreement
- D. recoverment

**30.** Choose the best way to join the following sentences:

They greeted a teenage girl like a hero.

She saved a drowning child's life.

- A. They greeted a teenage girl like a hero after she saved a drowning child's life.
- B. They greeted a teenage girl like a hero but she saved a drowning child's life.
- C. They greeted a teenage girl like a hero and she saved a drowning child's life.
- D. They greeted a teenage girl like a hero so she saved a drowning child's life.

**31.** Choose the correct sentence:

- A. I don't although in miracles believe, his recovery seems to defy the medical explanations.
- B. Although I don't believe in miracles, his recovery seems to confront the medical explanations.
- C. I don't believe in miracles although, his recovery to defy seems the medical explanations.
- D. I don't in miracles believe, his recovery although seems to defy the medical explanations.

**32.** Look at the words in the box:

offered – a – Kate – graduated – immediately – place - from - she - University – after - was

**The correct combination to form a sentence is:**

- A. Kate a place was offered after she from University immediately graduated.
- B. Kate after she immediately graduated was offered a place from University.
- C. Kate was offered a place immediately after she graduated from University.
- D. Kate after a place was offered from University immediately she graduated.

**33. Which word is different?**

- A. clinic
- B. hospital
- C. sanatorium
- D. hotel

**34. Choose the correct word to complete the following sentences:**

They decided to put that on \_\_\_\_\_ last minute.

I didn't know that his illness was at such an advanced \_\_\_\_\_.

- A. phase
- B. drama
- C. stage
- D. act

**35. Which word below does NOT rhyme with the word straight?**

- A. great
- B. night
- C. eight
- D. late

**36. In the string of words: water, milk, packet, petrol, money, the word packet is different because \_\_\_\_\_.**

- A. it is a countable noun
- B. it consists of six letters
- C. it consists of five sounds
- D. it is an uncountable noun

**37. Read the paragraph carefully:**

**Cotton has been grown for over five thousand years in places so far apart as Mexico, China, Egypt, and India.** It was a great luxury, more expensive than silk, because so many workers were needed to pick it. However, a huge increase in the number of slaves in the American South resulted in much greater cotton production and a fall of price. This, and new technology of the industrial revolution, made cotton the cheapest fabric in history.

**Look at the highlighted part of the text and complete the following sentence:**

**The author \_\_\_\_\_.**

- A. is sure that cotton was grown for five thousand years.
- B. is speculating about the origin of growing cotton.
- C. is certain about the history of growing cotton.
- D. knows when exactly the cotton cultivation began.

**38. When you see this sign, you instantly know that \_\_\_\_\_.**

- A. you are always allowed to park your car in the area.
- B. it's OK to park, it is not a strict 'No Parking' area.
- C. your car will be towed away if you park in the area.
- D. your parked car will be transported for free in this area.



**39. Many people in the world celebrate one day in the year as a special day for that particular person. It is not related to the days of the week. It is related to a date in a month and is celebrated every year. On this day, a person may give a party, friends may bring presents, and everybody is happy. This day is known as \_\_\_\_\_.**

- A. birthday
- B. mother's day
- C. father's day
- D. wedding day

**40. Read the following paragraph:**

Eileen works in a bank. She always goes to work by car. She drives for four kilometres to and from work every day. However, this is not all. After work she takes the children from school, which is three kilometres away from her working place. Then, together with them she goes to visit her mother to make sure that she is fine and doesn't need anything. That is additional five kilometres. On their way back home, they pass by the school and the bank. The distance Eileen travels **to work** is shorter from that **back home** for \_\_\_\_\_.


- A. three kilometres
- B. four kilometres
- C. five kilometres
- D. eight kilometres

**MATEMATIKË**

**41.** Pas thjeshtimit shprehja  $\left(\frac{x^2 + 2ax}{x + 2a}\right) : \left(\frac{x^2 + x}{x^2 - 1}\right)$  ka formën:


- A.  $x - 1$
- B.  $x + 1$
- C.  $\frac{1}{x - 1}$
- D.  $\frac{1}{x + 1}$

**42.** Cila nga figurat e mëposhtme paraqet shumën  $\vec{a} + \vec{b}$ ?




43. Cila nga shprehjet vijuese i përgjigjet pjesës së hijezuar në diagram?

- A.  $A \setminus (B \cup C)$
- B.  $(A \setminus B) \cap (B \cap C)$
- C.  $(A \setminus B) \cup (B \cap C)$
- D.  $B \setminus (A \cup C)$



44. Cila nga shprehjet vijuese paraqet perimetrin e figurës?

- A.  $4a + 2b$
- B.  $2a + b + 2x$
- C.  $a + 2b + 2x$
- D.  $2a + 4b$




45. Cilat janë zgjidhjet e ekuacionit:  $(3x - 1)^2 - 9 = 0$  ?

- A.  $x_1 = -\frac{2}{3}, x_2 = \frac{4}{3}$
- B.  $x_1 = \frac{2}{3}, x_2 = -\frac{4}{3}$
- C.  $x_1 = -\frac{2}{3}, x_2 = -\frac{4}{3}$
- D.  $x_1 = \frac{2}{3}, x_2 = \frac{4}{3}$

46. Është dhënë paralelogrami ABCD syprina e të cilit është  $S = 32 \text{ cm}^2$  dhe brinja  $[AB] = 8 \text{ cm}$ . Sa është syprina e trapezit PQRS të ndërtuar brenda paralelogramit?


- A.  $S = 4 \text{ cm}^2$
- B.  $S = 6 \text{ cm}^2$
- C.  $S = 8 \text{ cm}^2$
- D.  $S = 10 \text{ cm}^2$



47. Është dhënë grafiku i funksionit  $y = f(x)$ . Sa është vlera:

$$3f(-2) + 2 \cdot f(0) - f(2)?$$

- A.  $-2$
- B.  $-4$
- C.  $-6$
- D.  $-8$




**48.** Le të jetë syprina e një kubi  $S = 54 \text{ cm}^2$ . Në qoftë se tehu i kubit rritet për  $1 \text{ cm}$ , atëherë për sa  $\text{cm}^2$  rritet syprina e tij?

- A.  $38 \text{ cm}^2$
- B.  $40 \text{ cm}^2$
- C.  $42 \text{ cm}^2$
- D.  $44 \text{ cm}^2$

**49.** Në figurën e dhënë  $\overline{AB} \parallel \overline{XY}$ ,  $\overline{MN} \perp \overline{XY}$ ,  $\angle(NB, MB) = 30^\circ$  dhe  $\overline{NB} = 10 \text{ cm}$ . Sa është gjatësia e segmentit  $\overline{MN}$  ?

- A. 5
- B. 7
- C.  $5\sqrt{2}$
- D.  $7\sqrt{2}$



**50.** Janë dhënë gjykimet:

$$p: |-2| = 2$$

$$q: \frac{2}{3} + \frac{5}{4} = \frac{2+5}{3+4} = \frac{7}{7} = 1$$

$$r: \left. \begin{array}{l} x + y = 2 \\ x - y = 0 \end{array} \right\} \text{ është } x = 2, y = 0.$$

Cili nga pohimet është i saktë:

- A. Gjykimet  $q$  dhe  $r$  janë të saktë.
- B. Të tre gjykimet janë të saktë.
- C. Vetëm gjykimi  $q$  është i saktë.
- D. Vetëm gjykimi  $p$  është i saktë.

**51.** Me cilën nga shprehjet vijuese është e barabartë shprehja  $(3x^{-1})^3 \cdot x^2$  ?

- A.  $27x^{-1}$
- B.  $9x^{-3}$
- C.  $\frac{9}{x^3}$
- D.  $\frac{27}{x^3}$

**52.** Mesi aritmetik i numrave : 2, 6, 8, 11,  $x$ , 7 është i barabartë me 7. Sa është mesi aritmetik i numrave : 6, 7,  $x$ , 3?

- A. 5
- B. 6
- C. 7
- D. 8

**53.** Është dhënë numri kompleks  $z = 2 + i$  (ku  $i = \sqrt{-1}$ ). Sa është vlera e shprehjes  $w = z^2 - 2z + 1$ ?

- A.  $w = 4 + i$
- B.  $w = 4 - i$
- C.  $w = 2$
- D.  $w = 2i$

**54.** Hedhen dy zare, me numrat 1 deri në 6 të shënuar në faqet e tyre. Ngjarje elementare janë 36. Sa është gjasa që shuma e numrave të rënë nga hedhja e dy zareve është 4?

- A.  $P(A) = \frac{1}{6}$
- B.  $P(A) = \frac{1}{9}$
- C.  $P(A) = \frac{1}{12}$
- D.  $P(A) = \frac{1}{16}$

**55.** Për numrat  $a$  dhe  $b$  vlen:  $a \cdot b = 1$  dhe  $a$  është më i madh se 0. Cili nga pohimet vijuese është i saktë?


- A. Me rritjen e  $a$ , zvogëlohet  $b$
- B. Me rritjen e  $a$ , rritet  $b$
- C. Kur  $a$  është më i madh se 1,  $b$  është negativ
- D. Kur  $a$  është më i madh se 1,  $b$  është më i madh se 1

**56.** Në sa mënyra mund të ulen 7 persona në 4 ulëse?

- A. 28
- B. 35
- C. 38
- D. 45

**57.** Cili nga numrat e mëposhtëm është më afër gjatësisë  $d = \overline{OM}$ , ku  $O(0,0)$  dhe  $M(4,-7)$  (shih figurën)?

- A. 4
- B. 7
- C. 8
- D. 11



**58.** Në qoftë se  $n$  është numër i plotë, cili barazim i përgjigjet fjalisë: “Ndryshimi i katrorit të një numri tek me katrorin e paraardhësit tek të tij është 88”.

- A.  $(n+1)^2 - (2n-1)^2 = 88$
- B.  $(2n+1)^2 - 88(n-1)^2 = 0$
- C.  $(n+1)^2 - 88(n-1)^2 = 0$
- D.  $(2n+1)^2 - (2n-1)^2 = 88$

59. Numri i katrorëve në tabelën e mëposhtme është përcaktuar hap pas hapi sipas një rregulle.

| Hapat    | katroret   | nr  |
|----------|--|-----|
| Hapi 1   | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>  | 2   |
| Hapi 2   | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>  | 6   |
| Hapi 3   | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>   | 12  |
| Hapi 4   | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> | 20  |
| ...      | ...  | ... |
| Hapi $n$ |  |     |

Cila shprehje përcakton numrin e katrorëve në hapin e  $n$ -të ?

- A.  $n^2 + n$
- B.  $2n^2$
- C.  $4n - 2$
- D.  $5n - 3$


60. Janë dhënë vlerat e funksioneve trigonometrike:  $a = \tan 55^\circ$ ,  $b = \cot 55^\circ$ ,  $c = \cot 52^\circ$  dhe  $d = \tan 61^\circ$ . Cili nga inekuacionet e dhëna është i saktë?

- A.  $a < c < d < b$
- B.  $b < c < a < d$
- C.  $c < a < d < b$
- D.  $c < b < d < a$

## INFORMATIKË

61. Opsioni i zgjedhur në figurë mundëson:

- A. Fillimin e prezantimit
- B. Mbylljen e prezantimit
- C. Përgaditjen e prezantimeve
- D. Përgatitjen e nën prezantimeve



62. Kush e mundëson monitorin që të operoj me rezolucione të ndryshme grafike?

- A. Audio kartela
- B. Video kartela
- C. Kartela e rrjetit
- D. Kartela e memories

63. Cila nga keto protokole mundëson **web service**?

- A. TCP
- B. UDP
- C. HTTP
- D. FTP



64. Çfarë prapashtese kanë faqet e Internetit ?

- A. .xls
- B. .doc
- C. .gif
- D. .html

65. Cila nga njësitë e dhëna është njësi përbërëse e Mikroprocesorit (CPU-së)?

- A. Regjistrat
- B. Kartela grafike
- C. Ram memoria
- D. Pllaka amë

66. Në bazë të të dhënave në figure çfarë vlere do të fitohet në qelin B1?

- A. 0
- B. 10
- C. 12
- D. 15

|   | A  | B            | C  | D  | E |
|---|----|--------------|----|----|---|
| 1 |    | =MAX(C4: D8) |    |    |   |
| 2 |    |              |    |    |   |
| 3 | 15 |              |    |    |   |
| 4 |    |              | 10 |    |   |
| 5 |    |              |    | 12 |   |
| 6 |    |              |    |    |   |
| 7 |    |              |    |    |   |
| 8 |    |              |    |    |   |

67. Ne figure eshte treguar:

- A. Tastiera
- B. Skeneri
- C. Printeri
- D. Kartela e zerit



68. Çfarë domethënie ka aplikacioni i tipit **Shareware**:

- A. Mund të përdoret pa pagesë dhe të modifikohet
- B. Nuk mund të përdoret pa pagesë
- C. Mund të përdoret pa pagesë për periudha të pakufizuara
- D. Mund të përdoret pa pagesë për periudha të kufizuara

69. Cila është paisje dalëse ?

- A. monitori
- B. modemi
- C. mikrofoni
- D. tastjera

70. Veglat vijuese të programit **MS Access**



, përdoren për :

- A. Fshirjen e shënimeve
- B. Filtrimin e shënimeve
- C. Sortimin e shënimeve
- D. Kopjimin e shënimeve

## EDUKATË QYTETARE

- 71.** Si quhet organizimi i votuesve që dëshirojnë të ndikojnë dhe të kontrollojnë vendimmarrjen e qeverisë duke rekrutuar, emëruar dhe zgjedhur anëtarët për poste publike?
- A. Opozitë politike
  - B. Zgjedhje lokale
  - C. Parti politike
  - D. Ndërmarrje publike
- 72.** Nëse një personi të moshës madhore i ndalohet e drejta për të votuar si veprim, atëherë atij personi i cenohet:
- A. liria kolektive
  - B. liria individuale
  - C. integriteti personal
  - D. shprehja e mendimeve
- 73. Zëvendësoni vendin bosh me një term adekuat të shënuar me poshtë, që fjalisë së dhënë t'i jep kuptim:**
- \_\_\_\_\_ është proces ekonomik-shoqëror nëpërmjet të së cilit synohet të zhvillohet afrimi midis popujve e komuniteteve të përkatësive të ndryshme.
- A. Demokratizimi
  - B. Solidariteti
  - C. Globalizimi
  - D. Barazia
- 74.** Punët dhe përgjegjësitë e administratës komunale i përcakton :
- A. Kryeshefi ekzekutiv i komunës
  - B. Kryetari i komunës
  - C. Kuvendi i komunës
  - D. Deputeti i kuvendit komunal
- 75.** Grabitja është :
- A. formë e krimit kundër personit
  - B. formë e krimit të organizuar
  - C. formë e krimit të jakave të bardha
  - D. formë e krimit kundër pronës
- 76.** Çfarë kanë të përbashkët republika dhe diktatura?
- A. Janë forma të pabarazisë shoqërore
  - B. Janë forma të qeverisjes shtetërore
  - C. Janë forma të komunikimit publik
  - D. Janë forma të fesë/religjionit
- 77.** Iniciativa është:
- A. procedurë demokratike si votim i popullit për të bërë ligjet e veta
  - B. procedurë për të propozuar qeverinë e një vendi demokratik dhe sovran
  - C. nismë qytetare për të rrëzuar pushtetin e një vendi demokratik dhe sovran
  - D. nismë qytetare për të vënë me dhunë një qeveri demokratike në pushtet

**78.** Nëse personi A ka mendim për një çështje të caktuar që ka të bëjë me interesin publik, por ai nuk e shpreh publikisht atë mendim, atëherë themi se personi A:

- A. ruan me xhelozzi fshehtësinë publike
- B. është shumë diskret ndaj publikut
- C. nuk ka opinion publik
- D. nuk e përfill publikun

**79.** Nëse në televizion në një kohë të caktuar jepet lajmi se papunësia në një shtet ka një përqindje të caktuar, atëherë çfarë duhet analizuar në atë moment?

- A. Duhet analizuar se kush e thotë atë informacion dhe si ose në çfarë mënyre e thotë atë
- B. Duhet analizuar kualitetin, kuantitetin, prejardhjen dhe mënyrën e marrjes së informacionit dhe saktësinë e tij
- C. Duhet analizuar për çfarë e ka fjalën informanti në informacionet e dhëna dhe kujt i drejtohet
- D. Duhet analizuar se në cilin kanal televiziv jepet informacioni i caktuar me qëllim të konstatimit të besueshmërisë së tij

**80.** Varfëria absolute :

- A. përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave personale dhe familjare me të ardhurat e tjerëve
- B. përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave aktuale të personit me ato që ai pret të marr në të ardhmen
- C. përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave personale dhe familjare me koston e shpenzimeve që bëhen për shërbimet ndaj jetës
- D. përcaktohet nga krahasimi i të ardhurave personale me ato familjare

**81.** Efekti i serrës krijohet kur rrezet e diellit depërtojnë deri në sipërfaqen e tokës, e ngrohin tokën, me ç'rast lirohen gazra të shtresave të ulëta atmosferike të ngjashme me qelqin e serrës, duke bllokuar kështu një pjesë të nxehtësisë që reflektohet në gjithësi. Me rritjen e gazrave në serë:

- A. temperaturat në tokë do të jenë më të ulëta
- B. reshjet do të jenë më pak të ndotura
- C. temperaturat në tokë do të jenë më të larta
- D. thatësirat do të jenë më të pakta

**82.** Janë dhënë pohimet:

- I. Këshilli i Bashkimit Evropian ka dy pjesë, të cilat janë themeluar nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve anëtare dhe ka rol vendimmarrës
- II. Këshilli i Bashkimit Evropian ka dy pjesë, të cilat janë themeluar nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve anëtare dhe ka rol ekzekutiv/zbatues
- III. Këshilli i Bashkimit Evropian ka dy pjesë, të cilat janë themeluar nga përfaqësuesit e qeverive të shteteve anëtare dhe ka rol ekzekutiv/zbatues dhe vendimmarrës

Cili nga pohimet është i saktë lidhur me Këshillin e Bashkimit Evropian?

- A. Vetëm I
- B. Vetëm II
- C. I dhe II
- D. II dhe III

- 83.** Kushtetuta është:
- ligj themelor i një shteti, prej të cilit nuk buron asnjë ligj vendor në shtetet demokratike, sepse ato rrjedhin nga konventat ndërkombëtare
  - ligj themelor i një shteti, prej të cilit burojnë shumica e ligjeve vendore në shtetet demokratike
  - ligj penal i një vendi të caktuar sovran, demokratik dhe i pavarur
  - ligj themelor mbi presidentin dhe qeverinë e një shteti demokratik, sovran dhe të pavarur
- 84.** Cilat janë integrimet kryesore që duhet ndodhur me qëllim që të kemi një integrim në rajon?
- Integrimi arsimor, njerëzor, religjioz, ideologjik
  - Integrimi religjioz, botëkuptimor, juridik, bujqësor
  - Integrimi kulturor, religjioz, sportive dhe individual
  - Integrimi politik, ekonomik, arsimor, kulturor dhe sportiv
- 85.** Cila është detyra e Sekretariatit dhe Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut?
- Monitorimi, promovimi përmes arsimimit dhe programeve informative publike, Deklaratës për të drejtat e njeriut si dhe të folurit për abuzime eventuale të të drejtave të njeriut
  - Kontrollimi i armëve, i të drejtave të njeriut, monitorimin dhe sigurimi e zgjedhjeve
  - Koordinimi dhe kontrollimi i politikave ekonomike të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara
  - Evitimi i luftërave, menaxhimi i krizave, kthimi i paqes dhe i të drejtave të njeriut në një vend pas lufte

## EKONOMI ME NDËRRMARRËSI


- 86.** Tatimet mbi importe të cilat shtetet i vendosin kundrejt vlerës së mallrave të importuara apo për çdo njësi të mallrave të importuara njihen si:
- barriera jo doganore
  - tarifa doganore
  - subvencione
  - kuota
- 87.** Kontratat kolektive të cilat janë të lidhura në nivel shtetëror njihen si:
- teknike
  - të veçanta
  - të përgjithshme
  - informative
- 88.** Kapitali i investuar do të jetë më efikas apo norma e kthimit do të jetë më e lartë, nëse mjetet e investuara janë siguruar nga:
- kreditë vendore
  - mjetet vetanake
  - kreditë e jashtme
  - tregu financiar

**89.** Cilat nga xehet kanë ndikim më të madhë në zhvillimin ekonomik të Kosovës:

- A. plumbi, zinku, magneziumi, dhe qymyri
- B. alumini, zinku, bakri, dhe kaliumi
- C. nikeli, kaliumi, kromi, dhe zhiva
- D. plumbi, argjendi, alumini dhe indiumi

**90.** Në pikën **B** në grafik kemi një disekuilibër të tregut, pra kemi një tepricë të ofertës mbi kërkesë. Çka duhet të ndodh me çmimet që të arrihet ekuilibri i tregut?

- A. Çmimet në fillim duhet të zvogëlohen e pastaj të rriten
- B. Çmimet në fillim duhet të rriten e pastaj të zvogëlohen
- C. Çmimet duhet të rriten
- D. Çmimet duhet të zvogëlohen



**91.** Veçoritë kryesore të konkurrencës monopolistike janë:

- A. prania e një numri të madh të firmave në treg, liria për të ushtruar biznesin, aftësia e firmës për të ndikuar në çmime
- B. shitja e produkteve homogjene në treg, ekzistenca e zëvendësuesve të afërt, ekzistenca e pengesave në hyrje
- C. mungesa e zëvendësuesve të afërt, aftësia për të ndikuar në çmime, ekzistenca e pengesave të hyrjes në atë degë
- D. çmimet janë lehtësisht të ndryshueshme, ekzistenca e dy apo më shumë firmave në treg, mungesa e zëvendësuesve të afërt

**92.** Në periudhat e recensionit ekonomik masat të cilat i ndërmerr shteti për gjallërimin e ekonomisë në kuadër të politikës monetare kanë të bëjnë me:

- A. rritjen e ofertës monetare
- B. rritjen e tatimeve dhe taksave
- C. zvogëlimin e tatimeve dhe taksave
- D. zvogëlimin e ofertës monetare

**93.** Sa do të jetë norma e papunësisë nëse numri i banorëve në një vend është 1 700 000, numri i fuqisë punëtore është 1050000, kurse numri i të papunëve është 220000?

- A. 13.00%
- B. 19.95%
- C. 20.95%
- D. 24.00%

**94.** Dobia totale tregon:

- A. kënaqësinë e pjesërishtme shtesë që konsumatori e merr nga njësit shtesë të produkteve dhe shërbimeve të blera e të destinuara për konsum
- B. kënaqësinë totale që konsumatori e merr nga produktet dhe shërbimet e blera e të destinuara për konsum
- C. kënaqësinë totale që prodhuesit e realizojnë në produktet dhe shërbimet të cilat ato i prodhojnë
- D. kënaqësinë që blerësit dhe shitësit e arrijnë gjatë realizimit të qëllimeve të tyre

- 95.** Motivimi material i punëtorëve ka ndikim të madh në ngritjen e efikasitetit të ndërmarrjes dhe ka të bëjë me:
- A. ngritjen profesionale të punëtorëve dhe informimin e tyre në lidhje me tregun
  - B. përgatitjen psikologjike të punëtorëve për vendet e punës
  - C. sigurimin e bazës materiale, nëpërmjet pagave dhe marrjeve tjera
  - D. mënyrën e organizmit të punës dhe sistemimin e vendeve të punës
- 96.** Në periudhat e inflacionit të lartë si humbës apo në pozitë disfavorizuese qëndrojnë:
- A. huadhënësit, ata të cilët kanë dhënë kredi
  - B. huamarrësit, ata të cilët kanë marrë kredi
  - C. shteti si borxhli, nëse ka shitur letra me vlerë
  - D. ata të cilët kanë investuar mjetet e tyre në patundshmëri
- 97.** Çka tregon bilanci i gjendjes si pasqyrë financiare?
- A. Gjendjen e rezultatit financiarë të firmës për një periudhë të caktuar kohore
  - B. Gjendjen financiare të firmës në një datë të caktuar
  - C. Ndryshimet në kapitalin aksionarë në një datë të caktuar
  - D. Lëvizjet në rrjedhat e parasë gjatë një periudhe të caktuar kohore
- 98.** Funkzioni i prodhimit është më i suksesshëm nëse me:
- A. shpenzime më të mëdha prodhohen më pak produkte
  - B. numër më të madh të punëtorëve prodhohen më pak produkte
  - C. inpute më të mëdha prodhohen autpute më të vogla
  - D. inpute më të vogla prodhohen autpute më të mëdha
- 99.** Politikat e promovimit të produkteve dhe shërbimeve të cilat kanë rëndësi shumë të madhe në efikasitetin dhe efektivitetin e ndërmarrjeve kanë të bëjnë me:
- A. aktivitetet në lidhje me minimizimin e kostove të prodhimit të produkteve dhe shërbimeve
  - B. aktivitetet në lidhje me komunikimin e drejtpërdrejtë dhe tërthortë me tregun, informimin dhe tërheqjen e blerësve potencial
  - C. aktivitetet në lidhje me distribuimin dhe shitjen e produkteve dhe shërbimeve
  - D. aktivitetet në lidhje me përgatitjen e fuqisë punëtore për tregun e punës dhe përdorimin e teknologjisë së avancuar
- 100.** Me çfarë modeli të qeverisjes kemi të bëjmë nëse pronarët e ndërmarrjes bëjnë vet qeverisjen, menaxhimin e saj?
- A. Me model të tërthortë të qeverisjes
  - B. Me model të përzier të qeverisjes
  - C. Me model të drejtpërdrejtë të qeverisjes
  - D. Me model të participimit të punëtorëve në qeverisje